

# RELACION

## PËR

### PROJEKTLIGJIN “PËR MARRËVESHJEN E PAQES FISKALE”

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektligji “Për marrëveshjen e paqes fiskale” propozohet në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

Në kuadër të përpjekjeve për modernizimin e administrimit fiskal dhe ndërtimin e një marrëdhënieje më bashkëpunuese ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve, për rritjen e përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore, ky projektligj propozon krijimin e një instrumenti të përkohshëm ligjor për një marrëveshje të paqes fiskale për pagimin e tatimit mbi të ardhurat e korporatës ose të të ardhurave të biznesit bazuar mbi paracaktimin e fitimit të tatueshëm.

Synimi i kësaj marrëveshjeje është që të përmirësojë marrëdhënien ndërmjet tatimpaguesve dhe administratës tatimore, të inkurajojë përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore, si dhe të orientojë kontrollet tatimore në mënyrë më të saktë e të drejtë.

Projektligji nuk synon të zëvendësojë sistemin ekzistues të vetëdeklarimit të detyrimeve tatimore, por të krijojë një alternativë shtesë të dakordësuar paraprakisht për një kategori të caktuar tatimpaguesish, mbi bazën e kritereve objektive dhe të qarta. Marrëveshja parashikon një afat njëvjeçar zbatimi, me të drejtë rinovimi deri në dy herë dhe përfaqëson një qasje proaktive për ndërtimin e besimit të ndërsjellë ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesit.

Gjithashtu, projektligji u jep të drejtën tatimpaguesve, që hyjnë në marrëveshje, të rideklorojnë elementet e aktiveve, detyrimeve dhe kapitaleve të veta në pasqyrat financiare të tri viteve të mëparshme, duke përcaktuar mënyrën e trajtimit tatimor të diferencave, që dalin nga rideklarimi, si dhe përjashtimin nga përgjegjësia të audituesve ligjorë për këto diferenca. Ky parashikim ndalon përdorimin e rideklarimit për të ulur fitimin tatimor ose TVSH-në e pagueshme në të kaluarën apo në periudhat e ardhshme, si dhe parashikon përjashtimin nga dënimet administrative për këto raste.

Kjo ndërhyrje ligjore është pjesë e një strategjie më të gjerë për përmirësimin e administrimit tatimor, për ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme

ndërmjet administratës dhe tatimpaguesve, si dhe për përmirësimin e klimës së të bërit biznes në vend. Kjo qasje bazohet në filozofinë e dakordësisë paraprake, duke ofruar një mënyrë të strukturuar dhe transparente për të përcaktuar fitimin e tatueshëm në mënyrë të drejtë e të parashikueshme, si për administratën, ashtu dhe për biznesin. Në këtë mënyrë, përfitimet janë të dyanshme: biznesi fiton qartësi dhe stabilitet në planifikimin fiskal, ndërsa administrata tatimore siguron një mbledhje më të qëndrueshme dhe të garantuar të të ardhurave.

Kjo iniciativë mbështetet në praktika të ngjashme të ndjekura nga vende të tjera evropiane si Italia, e cila ka zbatuar një model të quajtur “paqe fiskale” (*pace fiscale*), me synim lehtësimin e barrës administrative dhe ndërtimin e një raporti më bashkëpunues ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve, si dhe për të përmirësuar efikasitetin e mbledhjes së të ardhurave, në kuadër të një politike tatimore afatshkurtër.

Në përputhje me këto praktika dhe në kontekstin e nevojës për të modernizuar marrëdhënien ndërmjet tatimpaguesve dhe administratës tatimore, projektligji synon të sjellë një mjet të ri ligjor, që:

- përmirëson klimën e të bërit biznes në vend;
- rrit efektivitetin e administrimit fiskal;
- stimulon përmbushjen vullnetare;
- jep të drejtën për rivlerësimin e pasqyrave financiare të subjekteve që pranojnë marrëveshjen, pa dënime administrative apo gjoba, pa kontroll tatimor, duke rritur besueshmërinë e tyre financiare dhe kontabël;
- promovon transparencën dhe parashikueshmërinë në sistemin tatimor.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj është në përputhje me programin qeverisës 2025 - 2029, shtylla II – rritja ekonomike e qëndrueshme, pika 2.1 “Financat publike dhe politika fiskale”, në të cilën është përcaktuar se: “Çelim një kapitull të ri bashkëpunimi me sipërmarrjen shqiptare përmes marrëveshjeve disavjeçare të lehtësimit tatimor dhe nxitjes së deklarimeve të rregullta, duke zbatuar “Paqen fiskale” 2026 – 2029: faljen e detyrimeve tatimore më të vjetra se 10 vjet; skemën e ripagimit të borxheve të 10 viteve të fundit me përqindje të reduktuara.”.

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektligji “Për marrëveshjen e paqes fiskale” propozohet si një instrument i përkohshëm, me kohëzgjatje trivjeçare, i cili synon të krijojë një regjim të posaçëm e të paracaktuar të vlerësimit të fitimit të tatueshëm për tatimpaguesit, që përmbushin kritere të caktuara. Gjithashtu, tatimpaguesve u jepet e drejta të zgjedhin të rideklojnë pasqyrat financiare të 5 viteve të mëparshme, kundrejt pagesës së një tatimi, në masën 5%. Ky instrument do të shërbejë për të siguruar një kuadër të dakordësuar paraprakisht për përmbushjen fiskale dhe për shmangien e mosmarrëveshjeve tatimore lidhur me tatimin mbi të ardhurat e korporatës apo të ardhurave biznesore. Kjo marrëveshje nuk prodhon efekte për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar apo tatimeve të tjera, zbatimi i të cilave bëhet sipas rregullave të zakonshme.

Tatimpaguesit që mund të lidhin marrëveshje me administratën tatimore në kuadër të këtij projektligji janë të gjitha subjektet me të ardhura bruto mbi 14 milionë lekë, qofshin persona fizikë apo entitete dhe që nuk përfitojnë nga aplikimi i normave të reduktuara apo përjashtimet tatimore. Këta tatimpagues, nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë me administratën tatimore, do të kenë mundësi të përcaktojnë paraprakisht bazën e tatueshme dhe detyrimin përkatës tatimor për një vit, me mundësi rinovimi deri në dy vite të tjera.

Ky mekanizëm vjen si pjesë e një qasjeje të re në marrëdhënien ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve, me qëllim garantimin e një baze të qëndrueshme tatimore, reduktimin e ndërhyrjeve subjektive dhe rritjen e parashikueshmërisë në sistemin fiskal.

Zbatimi i marrëveshjes së paqes fiskale është frymëzuar nga modele të ngjashme të aplikuara në vende të Bashkimit Europian si Italia, ku është përdorur koncepti i “*pace fiscale*” si një mjet për të përmirësuar vullnetin për përmbushje, për të reduktuar konfliktet tatimore dhe për të nxitur transparencën në deklarimin e të ardhurave. Ky mekanizëm synon të krijojë një marrëveshje të dakordësuar paraprakisht për vlerën e fitimit të tatueshëm dhe detyrimin përkatës tatimor për një vit tatimor, me të drejtë rinovimi për dy vite të tjera.

Në thelb, projektligji parashikon që administrata tatimore llogarit fitimin e tatueshëm të vlerësuar, i cili parashikohet në kontratën e marrëveshjes dhe llogaritet si fitimi i tatueshëm i vitit të mëparshëm plus 18% marzh rritjeje të këtij fitimi për periudhën për të cilën lidhet marrëveshja. Për çdo fitim të tatueshëm, që tejkalon këtë vlerë, tatimpaguesi paguan një tatim shtesë prej 5%. Marrëveshja e lidhur ka efekt ligjor dhe përjashton tatimpaguesin nga kontrolli tatimor për

tatimin mbi të ardhurat e korporatës ose të ardhurave të biznesit, për periudhën e vlefshmërisë, përveç rasteve të mashtrimit apo të deklarimeve të rreme.

Ky projektligj nuk synon të zëvendësojë sistemin aktual të vetëvlerësimit, por të ofrojë një alternativë të dakordësuar për një periudhë afatmesme 3-vjeçare, për subjektet që përmbushin kriteret e përcaktuara, siç janë: mungesa e detyrimeve të papaguara, mosqenia në proces penal apo hetim tatimor dhe një histori pozitive përputhshmërie fiskale. Në këtë mënyrë, ndërhyrja shërben si një mekanizëm filtrues, i cili shpërblen korrektësinë dhe shmang përfshirjen e subjekteve me risk të lartë evazioni apo shkeljesh të rënda, duke inkurajuar formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë.

Tatimpaguesit, të cilët do të shprehin vullnetin për të aplikuar për marrëveshje, kanë të drejtën që të korrigjojnë pasaktësitat në deklaratimet e mëparshme, në pasqyrat e tyre financiare. Për ndryshimet mes deklaratimit të vjetër dhe deklaratimit të ri, të vetëkorrigjuar, deri në 30% nga deklaratimet e mëparshme, për secilin vit, do të paguhet tatim në masën 5%, me synimin për të siguruar një paraqitje reale, të vërtetë e të drejtë të çdo elementi të aktiveve dhe të detyrimeve të këtyre pasqyrave.

Rivlerësimi i pasqyrave financiare do të bëhet për deri në 3 vitet e fundit, duke rishikuar apo korrigjuar zëra të ndryshëm, deri në 30%, kundrejt një pagese tatimi, si më poshtë:

1. Aktive monetare - rideklarim i gjendjes së keshit të shoqërisë (ulje apo rritje). Tatim në masën 5% të çdo devijance negative apo pozitive nga gjendja reale e *cash-it*;
2. Aktivitetet e tjera financiare - fshirja e shumave fiktive në zërin “Kërkesa të arkëtueshme”. Tatim në masën 5% për fshirjen e detyrimeve fiktive;
3. Fshirja e aktiveve afatgjata material/jomateriale fiktive të deklaruara. Tatim në masën 5% përkundrejt fshirjes së inventarit fiktiv;
4. Deklarim i aktiveve afatgjata materiale të papërfshira në pasqyrat financiare. Tatim në masën 5% për përfshirjen e aktivitetit afatgjatë material/jomaterial;
5. Fshirja e detyrimeve fiktive/borxheve në pasqyrat financiare. Fshihen detyrimet duke i konsideruar të ardhura të patatueshme përkundrejt pagesës së tatimit në masën 5%;
6. Rideklarim i fitimit mbartur të shoqërisë dhe shpërndarja si dividend/fitim i tij. Tatim në masën 5 % për dividendin dhe ndarjen e fitimeve.

Për të gjitha transaksionet e mësipërme nuk do të aplikohen dënimet administrative të parashikuara në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të tilla, si:

gjoba, interesa dhe kamatëvonesa, në mënyrë që të inkurajohet korrigjimi dhe transparenca financiare. Ky përjashtim synon të nxisë pjesëmarrjen vullnetare të tatimpaguesve në procesin e rideklarimit dhe të sigurojë zbatimin efektiv të paqes fiskale, pa penalitete administrative për pasaktësi të së kaluarës. Megjithatë, ky lehtësim nuk i zhvesh tatimpaguesit nga detyrimet dhe përgjegjësitë që mund të lindin sipas ligjeve të tjera në fuqi.

Kjo është një lehtësi që u jepet tatimpaguesve, të cilët duhet ta deklarojnë që do ta përdorin që në momentin e aplikimit tek administrata tatimore për marrëveshjen. Tatimpaguesit, të cilët nuk dëshirojnë të bëjnë rivlerësimin e deklaratave, mund të vazhdojnë lidhjen e marrëveshjes vetëm me elementet e fitimit të tatueshëm, normës dhe pagimit të tatimit mbi të ardhurat e korporatave dhe të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi.

Kjo ndërhyrje mbështet objektivat e reformës së administrimit tatimor, duke përmirësuar efikasitetin e kontrolleve përmes fokusimit të burimeve tek zonat me risk, si dhe duke ndihmuar në konsolidimin e të ardhurave buxhetore në mënyrë të qëndrueshme e të planifikuar.

Përvoja ndërkombëtare tregon se instrumente të tilla, të aplikuara me kritere të qarta dhe me transparencë të plotë, jo vetëm që rrisin përmbushjen vullnetare, por edhe përmirësojnë perceptimin e drejtësisë tatimore. Në këtë kuptim, nisma është një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të marrëdhënieve tatimore në Shqipëri dhe forcimit të kulturës së përgjegjshmërisë fiskale.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar duke u mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përbëhet nga 14 nene, të cilat parashikojnë, si më poshtë vijon:

Neni 1 përcakton objektin e këtij projektligji, ku parashikohet se projektligji përcakton rregullat dhe procedurat për lidhjen e marrëveshjeve paraprake ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve mbi vlerësimin e paracaktuar të fitimit të tatueshëm dhe pagimit të tatimit mbi të ardhurat e korporatave dhe të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi, si dhe të drejtën për rivlerësimin e pasqyrave financiare të tri viteve të mëparshme.

Neni 2 parashikon se ky projektligj ka për qëllim të nxisë përmbushjen vullnetare të tatimit mbi të ardhurat e korporatave dhe tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi, si dhe rivlerësimin e pasqyrave financiare përmes një marrëveshjeje njëvjeçare, kundrejt mosushtimit të kontrollit tatimor për këtë tatim gjatë vitit tatimor të marrëveshjes.

Neni 3 parashikon fushën e zbatimit, ku do të përfshihen: tatimpaguesit e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit; tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e korporatës dhe tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi, por që nuk përfitojnë nga ndonjë përjashtim apo normë e reduktuar, sipas nenit 69 të ligjit nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar; dhe tatimpaguesit që përmbushin kushtet e kriteret e përcaktuara në projektligj. Gjithashtu, parashikohet se marrëveshja ka afat njëvjeçar, por me të drejtë rinovimi edhe dy herë të tjera.

Neni 4 parashikon përkufizimet për termat: marrëveshje e paqes fiskale, tatimpagues, administrata tatimore, vlerësim i fitimit të tatueshëm, normë tatimore e marrëveshjes, rinovimi i marrëveshjes dhe afati i vlefshmërisë.

Neni 5 parashikon fitimin e tatueshëm dhe tatimin gjatë marrëveshjes, ku konkretisht përcaktohet se aplikimi për lidhjen e marrëveshjes bëhet me anë të aplikimit në platformën elektronike *e-filing*. Administrata tatimore përcakton fitimin e tatueshëm të vlerësuar në marrëveshje, i cili është fitimi i tatueshëm i vitit të mëparshëm i rritur me 18% si marzh rritjeje i periudhës. Ndërkohë, tatimi mbi të ardhurat e korporatës ose tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi, për shumën e paracaktuar të fitimit të tatueshëm, do të llogaritet duke zbatuar normat standarde të tatimit, siç janë të përcaktuara në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Ndërkohë, nëse fitimi i tatueshëm i subjektit do të rezultojë më i lartë sesa fitimi i parashikuar në marrëveshje, tejkalimi i fitimit të tatueshëm do të tatohet me normën 5%.

Neni 6 përcakton se tatimpaguesit që lidhin “Marrëveshjen e paqes fiskale” kanë të drejtë të rideklojnë elemente të veçanta të aktiveve, detyrimeve ose kapitaleve të veta të pasqyrave financiare për tri vitet e mëparshme, me qëllim që të sigurojnë një paraqitje të saktë dhe reale të tyre. Në këtë proces, audituesit

ligjorë përjashtohen nga përgjegjësia për diferencat që rezultojnë si efekt i rideklarimit. Për çdo ndryshim deri në 30% mes gjendjes reale dhe asaj kontabël që sjell rritje të të ardhurave ose kapitalit, subjekti paguan tatim 5% sipas llojit të aktivëve apo detyrimeve (përfshirë gjendjen *cash*, aktivet financiare, pasuritë materiale, detyrimet fiktive dhe fitimet e pashpërndara). Diferencat kontabilizohen sipas rregullave të kontabilitetit, duke u trajtuar si të ardhura të patatueshme ose shpenzime të pazbritshme. Detyrimet ndaj ortakëve të rivlerësuar mund të përdoren lirisht nga ata, ndërsa rideklarimet nuk mund të ndikojnë në uljen e fitimit tatimor apo të TVSH-së. Për këto transaksione nuk zbatohen dënime administrative dhe nuk ushtrohet kontroll tatimor.

Neni 7 parashikon kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për të përfituar nga marrëveshja, të cilat janë: persona fizikë dhe entitete të regjistruara në regjistrin tatimor dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Shqipërisë; nuk kanë detyrime tatimore të papaguara ose të padeklaruara; nuk janë në proces ankimi administrativ; nuk janë subjekt i procedimeve penale për vepra në fushën tatimore; nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë për mashtrim tatimor, pastrim të produkteve të veprës penale ose fshehje të ardhurash; nuk janë subjekt hetimi nga administrata tatimore; nuk realizojnë projekte koncesionare.

Neni 8 parashikon detyrimet tatimore të përfshira në marrëveshje, ku përfshin vlerësimin dhe paracaktimin e fitimit të tatueshëm nga veprimtaria ekonomike e tatimpaguesit dhe normës tatimore për tatimin mbi të ardhurat të korporatave dhe tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi, si dhe normës së tatimit për rideklarimin e elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë, sipas edhe përcaktimeve në këtë ligj.

Neni 9 parashikon efektet juridike dhe kufizimin e kontrolleve tatimore, ku parashikohet se marrëveshja e paqes fiskale është e detyrueshme për palët për periudhën e vlefshmërisë, për tatimin mbi të ardhurat e korporatave dhe tatimin mbi të ardhurat personale nga biznesi dhe, gjatë kësaj periudhe, nuk kryhen kontrole tatimore në terren, përveç rasteve kur, për tatimpaguesin, është regjistruar një çështje hetimore në proces, për konsumin e veprës penale të krijimit të skemave mashtruese me tatimin mbi vlerën e shtuar apo fshehje e të ardhurave, sipas parashikimeve në Kodin Penal. Subjektet e parashikuara në këtë ligj i nënshtrohen monitorimit periodik nga zyra gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes. Vlerësimi/verifikimi nga zyra për qëllime monitorimi do të bëhen sipas ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 10 parashikon rastet e përfundimit të marrëveshjes si shkak i situatave që mund të ndodhin gjatë periudhës së zbatimit. Rastet janë kur tatimpaguesi ndryshon llojin e veprimtarisë së deklaruar në marrëveshje; pezullon apo ndërpret përfundimisht aktivitetin ekonomik; ka kryer shkelje të përsëritura të detyrimeve tatimore, që cenojnë ndershmërinë fiskale; nuk paguan detyrimet sipas marrëveshjes; nuk përmbush më kushtet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji; ka realizuar një rritje të fitimit të tatueshëm mbi 50% gjatë vitit tatimor, për të cilin është lidhur marrëveshja, krahasuar me vitin tatimor paraardhës. Gjithashtu, ky nen parashikon se, nëse marrëveshja përfundon sipas pikave më lart, për pasqyrat e rivlerësuar, administrata tatimore kryen kontrollin dhe rivlerësimin e detyrimit tatimor, në përputhje me normat e përcaktuara në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Neni 11 parashikon hapat dhe procedurat për aplikimin dhe propozimin e marrëveshjes, duke përcaktuar mënyrën e komunikimit përmes sistemit elektronik, afatet dhe formatin e propozimit, që i dërgohet tatimpaguesit nga administrata tatimore.

Neni 12 parashikon efektet e pranimi të marrëveshjes, ku tatimpaguesi zgjedh ta pranojë ose jo marrëveshjen brenda datës 15 prill, për vitin në të cilin lidhet marrëveshja. Pranimi bëhet me anë të nënshkrimit elektronik dhe marrëveshja konsiderohet e lidhur dhe ka efekt ligjor për vitin tatimor përkatës. Parapagimet paguhen bazuar në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Të dhënat e deklaruara i nënshtrohen kontrollit nga zyra sipas legjislacionit dhe mospërmbushjet e deklaramentit dhe pagesës do të konsiderohen shkelje tatimore.

Neni 13 parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij projektligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e projektligjit.

Neni 14 përmban parashikimin ligjor për hyrjen në fuqi të ligjit dhe afatin për shtrirjen e efekteve të tij.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe administrata tatimore.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Efektet e këtij projektligji nuk mund të parashikohen për arsye se projektligji bazohet në kërkesat vullnetare të tatimpaguesve për zbatimin e këtij ligji.

### **KËSHILLI I MINISTRAVE**